



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:194195
Datë: 23.04.2024
Numri i dokumentit: 05609827

PAKR.nr.32/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda me kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku - kryetar i kolegjit, Kadrije Goga Lubishtani dhe Xhevdet Abazi - anëtarë të kolegjit, me praktikanten gjyqësore Erna Stublla si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve E. S për shkak të veprës penale falsifikim i parasë nga neni 296 par.2 lidhur me par.1 të të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), L. R dhe E. S të dy për shkak të veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 e 77 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesave të mbrojtësit të akuzuarit L. R, av. Avdulla Gashi dhe të mbrojtësit të akuzuarit E. S, av. Begzad Hajrullahu, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjiilan - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.158/23 i datës 16.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 15.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si e të pabazuara ankesa e mbrojtësit të akuzuarit L. R, av. Avdulla Gashi dhe të mbrojtësit të akuzuarit E. S, av. Begzad Hajrullahu, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjiilan - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.158/23 i datës 16.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjiilan - Departamenti për Krime të Rënda me aktgjykimin PKR.nr.158/23 të datës 16.10.2023, të akuzuarit L. R dhe E. S, të dy për shkak të veprës penale falsifikim i parasë nga neni 296 par.2 lidhur me par.1 e nenin 31 dhe 77 të KPRK-së, i ka shpallur fajtor dhe të akuzuarit L. R i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje nëntëdhjetë (90) ditë, i cili dënim më kërkesën e të akuzuarit është zëvendësuar në dënim më gjobë në lartësi 1000 €, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 10.09.2023 deri me datën 10.10.2023, ndërsa është detyruar që pjesën e mbetur të e paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Ndërsa, të akuzuarit E. S i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje nëntëdhjetë (90) ditë, i cili dënim me kërkesën e të akuzuarit është zëvendësuar në dënim me gjobë në lartësi 1000 €, të cilin është obliguar që të e paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Janë obliguar të akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor, kësaj Gjykatë të i paguajnë shumat tridhjetë euro (30 €) secili prej tyre, si dhe nga pesëdhjetë euro (50 €) në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Janë konfiskuar bankënotat e falsifikuara nga njëzet euro (20 €), të gjitha në shumën katërqind e gjashtëdhjetë euro (460 €), të cilat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të asgjësohen nga njësitë i posaçëm i Policisë së Kosovës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

Mbrojtësi i të akuzuarit L. R, av. Avdulla Gashi, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj në tërësi ankesën e tij dhe ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjiilan - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.158/2023 i datës 16.10.2023, ashtu që të akuzuarit L. R të i shqiptojë dënim më të butë, sipas kriterëve për zbutjen e dënimit deri në tridhjetë (30) ditë burgim.

Mbrojtësi i të akuzuarit E. S, av. Begzad Hajrullahu, për shkak të vendimit mbi dënim, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj ankesën e tij si të bazuar dhe ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjiilan - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.158/2023 i datës 16.10.2023, ashtu që të akuzuarin E. S ta liroj nga ky dënim shumë i rëndë dhe ndaj të njëjtit të caktojë një dënim me gjobë më të butë.

Prokuroria e Apelit me parashtresën PPA/I.nr.42/2024 e datës 24.01.2024 ka propozuar që të refuzohet si të pabazuara ankesat e mbrojtësit të akuzuarit L. R, av. Avdulla Gashi dhe e

mbrojtësit të akuzuarit E. S, av. Begzad Hajrullahu, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.158/2023 i datës 16.10.2023, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi shkresat e lëndës studioi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit L. R, av. Avdulla Gashi dhe të mbrojtësit të akuzuarit E. S. Av. Begzad Hajrullahu, së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit L. R, av. Avdulla Gashi

Mbrojtësi i të akuzuarit L. R, av. Avdulla Gashi, konsideron se në rastin konkret, Gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me të drejtën materiale, sepse për shqiptimin e dënimit nuk është bazuar në dispozitat për zbutjen e dënimit në kuadër të rrethanave lehtësuese, por është bazuar në dispozita të cilat kanë rezultuar me kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsytimit të aktgjykimit të atakuar. Sipas mbrojtjes, Gjykata i është referuar disa dispozitave të pabazuara me rastin e shqiptimit të dënimit, përkatësisht i është referuar nenit 4, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 73, 74, 75 dhe nenit 76 të KPRK-së. Po ashtu, mbrojtja në ankesë citon rrethanat lehtësuese që Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se i ka vlerësuar, mirëpo konsideron se Gjykata në të vërtetë nuk ka vlerësuar pranimin e fajësisë, sepse po t'i kishte vlerësuar aktgjykimi i ankimuar do të ishte i bazuar në nenin 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së.

Tutje, sipas vlerësimit të mbrojtjes dënimi i shqiptuar është dënim shumë i lartë nëse marrim parasysh dominimi e rrethanave posaçërisht lehtësuese, prandaj ky dënim nuk është i drejtë dhe as në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale. Këtë vlerësim mbrojtja e argumenton me faktin se i akuzuari kishte vetëm katër dhjetë euro (40 €) të falsifikuara, të cilat pa dijeni se janë të falsifikuara i ka vënë në qarkullim, si dhe me faktin që i njëjti ishte viktimë e shoqërimit me persona të padëshiruar.

Për më tepër, mbrojtja konsideron se Gjykata është dashur të shfrytëzoj të drejtën e shqiptimit të dënimit nën kufirin e paraparë me ligj, ashtu siç parashihet me nenin 71 dhe 72 të KPRK-së, sepse edhe me zbatimin dispozitës për zbutjen e dënimit deri në tridhjetë (30) ditë burgim do të arrihej qëllimi i dënimit siç parashihet me ligj.

Së fundmi, mbrojtja thekson se Gjykata e shkallës së parë me rastin e zëvendësimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë, ka konstatuar se në dënimin me gjobë të akuzuarit do të i llogaritet dhe koha e kaluar në paraburgim, ndërsa e ka detyruar që pjesën tjetër të mbetur të gjobës të e paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, mirëpo askund nuk ka definuar shprehimisht se cila është vlera e mbetur e gjobës.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuari E. S, av. Begzad Hajrullahu

Mbrojtësi i të akuzuarit E. S, av. Begzad Hajrullahu konsideron se dënimi i shqiptuar është jashtëzakonisht i ashpër dhe i pa përballueshëm për të mbrojturin e tij, duke pasur parasysh faktin se i njëjti është mbajtës i familjes dhe i pa punë. Pagesa e kësaj gjobe do të i krijonte shumë vështirësi familjes së tij. Mbrojtja thekson se vet Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar ka theksuar se ka marrur në konsideratë pranimin e fajësisë, i ka falur besimin bashkëpunimit me gjykatën, pendimit të shprehur për veprën e kryer penale, keqardhjes, kërkim faljes publike dhe premtimit të dhënë nga i mbrojturi im se në të ardhmen nuk do të kryer vepra të tjera penale, andaj për shkak të ekzistimit të këtyre rrethanave dhe gjendjes së dobët ekonomike të akuzuarit, propozon që të njëjtit të i shqiptohet një dënim më gjobë më i butë.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Ndonëse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin lidhur me shkeljet e tilla e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 394 par.1 të KPPK-së, gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit përkitazi me shkeljen e ligjit penal

Ndërkaq, lidhur me pretendimin e mbrojtësit të akuzuarit L. R, av. Avdulla Gashi se Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të ligjit penal kur në dispozitivin e aktgjykimi të ankimuar i është referuar neneve të pabazuara, ky Kolegj konsideron se referimi në nenet si në dispozitivin e aktgjykimi të atakuar i vlerëson si gabim teknik nga ana e Gjykatës së shkallës së parë, pasi që i njëjti nuk ka ndikuar në marrjen e vendimit mbi dënimin. Andaj, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktgjykim i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje të ligjit penal pasi që dispozitivi të njëjtit është i kuptueshëm, në të nuk ka kundërthënie me vetveten e as me arsyet e tij, është i qartë dhe konkret.

Po ashtu, me ankesat e ushtruara kundër aktgjykimit të atakuar, nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar Gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate (pasi që nuk mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me këtë bazë ankimore meqë të akuzuarit kanë pranuar fajësinë). Prandaj, aktgjykimi u vlerësua vetëm lidhur me pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuari L. R, av. Abdulla Gashi dhe mbrojtësit të akuzuarit E. S, av. Begzad Hajrullahu, sa i përket shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin.

Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me vendimit mbi dënimin

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit konstaton se pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit L. R, av. Abdulla Gashi dhe mbrojtësit të akuzuarit E. S, av. Begzad Hajrullahu, janë të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësisë së dënimit, kështu duke vlerësuar si rrethanë lehtësuese për dy të akuzuarit pranimin e fajësisë, faktin që janë penduar, kanë kërkuar falje për kryerjen e kësaj vepre penale, si dhe premtimin e tyre ndaj Gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra të tilla apo të tjera penale. Andaj, bazuar në këto rrethana lehtësuese dhe duke mos gjetur rrethana rënduese lidhur me të akuzuarit, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo Gjykatë dhe gjen se Gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, në rastin konkret Gjykata e shkallës së parë, vetëm se ka vlerësuar të gjitha rrethanat e lehtësuese lidhur me të akuzuarit dhe si rezultat i tyre të njëjtëve i ka shqiptuar dënimin përkatës me burgim, të cilin pas kërkesës së vet të akuzuarve e ka zëvendësuar me dënim me gjobë. Andaj, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit edhe të kësaj Gjykate janë bazë e mjaftueshme për arsyetimin e dënimit të shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe më intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se më të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitave të këtij aktgjykimi konform nenit 401 të KPPRK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti për Krime të Rënda

PAKR.nr.32/24, dt. 15.04.2024

Praktikantja gjyqësore

Erna Stublla

Anëtarët e kolegjit

Kadrije Goga Lubishtani

Kryetar i kolegjit

Hashim Çollaku

Xhevdet Abazi
